



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
K U V E N D I

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

PËR

**TRAJTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E MJETEVE RRUGORE, LUNDRUESE, TË
KONFISKUARA, SI PASOJË E SEKUESTRIMIT, NDALIMIT ADMINISTRATIV, NGA
POLICIA E SHTETIT DHE MJETEVE TË TJERA**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i ligjit është rregullimi i procedurave të trajtimit, administrimit dhe nxjerrjes në ankand publik të mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga Policia e Shtetit, si dhe mjeteve të tjera.

Neni 2

Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

- mjetet rrugore, të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga organet e Policisë së Shtetit, të cilat nuk kanë statusin juridik “provë materiale”.
- mjetet rrugore, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, me ose pa targa regjistrimi/leje qarkullimi nga një shtet i huaj, të cilat nuk kanë statusin juridik “provë materiale”.

- c) mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe me certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit, të cilat nuk kanë statusin juridik “provë materiale”.
- ç) mjetet lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare, me ose pa leje lundrimi nga një shteti huaj, të cilat nuk kanë statusin juridik “provë materiale”.
- d) mjete të tjera, sipas nenit 7, të këtij ligji.

KREU II MJETET RRUGORE

Neni 3

Mjetet rrugore, të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi

Mjetet rrugore, të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga organet e Policisë së Shtetit, të cilat nuk kanë statusin juridik “provë materiale”, kalojnë për procedura të mëtejshme për shitje në ankand nga Policia e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për ankandin publik.

Neni 4

Mjetet rrugore, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi

Mjetet rrugore, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, me ose pa targa regjistrimi/leje qarkullimi nga një shtet i huaj, pas rikonfirmimit të verifikimeve me shtetet e origjinës, kalojnë për procedura të mëtejshme për shitje në ankand nga Policia e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për ankandin publik.

KREU III MJETET LUNDRUESE

Neni 5

Mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi

Mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe me certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit të cilat nuk kanë statusin juridik “provë materiale”, kalojnë për procedura të mëtejshme për shitje në ankand nga Policia e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për ankandin publik.

Neni 6

Mjetet lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara

Mjetet lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje lundrimi dhe certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues nga organet kompetente shqiptare, me ose pa leje

lundrimi nga një shteti huaj, pas rikonfirmimit të verifikimeve me shtetet e origjinës, kalojnë për procedura të mëtejshme për shitje në ankand nga Policia e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për ankandin publik.

KREU IV MJETE TË TJERA

Neni 7 Mjete të tjera

Mjetet që janë ndaluar administrativisht për mangësi në dokumentacion, mjetet e braktisura apo mjetet e debitorëve, për të cilat poseduesit e tyre nuk shfaqin interes për kthimin brenda 90 ditëve nga ndalimi administrativ, kalojnë për administrim dhe procedura të mëtejshme për shitje në ankand nga Policia e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për ankandin publik.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE

Neni 8 Mjete të tjera në cilësinë e provës materiale

Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, për mjetet rrugore ose lundruese dhe mjetet e tjera me status të panjohur, por në cilësinë e provës materiale që gjenden në mjediset e Drejtorive Vendore të Policisë dhe Drejtorive Vendore të Policisë së Kufirit dhe Migracionit, brenda afatit 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcaktojnë statusin juridik të tyre dhe kalojnë për administrim nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për ndjekjen e procedurave të mëtejshme, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e kësaj agjencie.

Neni 9 Kalimi i mjeteve

Kalimi i këtyre mjeteve nga mjediset e Drejtorive Vendore të Policisë dhe Drejtorive Vendore të Policisë së Kufirit dhe Migracionit, së bashku me dokumentacionin shoqërues të mjetit, bëhet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji pranë mjediseve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e kësaj agjencie ose nxirren në ankand publik nga Policia e Shtetit.

Neni 10 Të ardhurat

Të ardhurat e gjeneruara, sipas përcaktimeve në nenet 3, 4, 5, 6, 7 dhe 9, të këtij ligji do të kalojnë përkatësisht në favor të buxhetit të Policisë së Shtetit dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, ku një pjesë e këtyre të ardhurave do të përdoren

për transferimin e këtyre mjeteve nga mjediset e pikave të bllokimit në ambientet e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Neni 11
Aktet nënligjore

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzim të përbashkët për rregullimin e procedurave për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore, lundruese dhe mjeteve të tjera të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga Policia e Shtetit.

Neni 12
Shfuqizime

Ligji nr. 130/2012, “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga Policia e Shtetit deri në datën 30.12.2010”, shfuqizohet.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
LINDITA NIKOLLA